



AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Konferenca e V-të vjetore

Cilësia në AAP

Atraktivitet në tregun e punës

AAAPARr, qellimi, vizioni

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) ka për mision dhënien e mbështetjes në drejtim të fuqizimit dhe zhvillimit të arsimit dhe aftësimin profesional dhe arsimit për të rriturit në të gjithë Republikën e Kosovës, në përpjekje të vazhdueshme për të arritur standardet Evropiane. Në përmbushje të qëllimit të saj, AAAPARr synon të arrijë zhvillimin e arsimit dhe aftësimin profesional në lidhje me nevojat e teknologjisë moderne, tregun e punës dhe zhvillimit social të vendit, duke ju përshtatur kështu rrethanave të krijuara dhe ndryshimeve të shpejta teknologjike, në mënyrë që nxënësit dhe studentët tanë të jenë në hap me trendet e mesimnxënies dhe mesimdhënies gjithashtu me trendet e mesimdhënies.

6 qendrat e Kompetences

- Qendra e Kompetences "Shtjfen Gjecovi", Prishtine
- Qendra e Kompetences, ne Skenderaj
- Qendra e Kompetences "Kujtim Krasniqi", Malisheve
- Qendra e Kompetences "11 Marsi", Prizren
- Qendra e Kompetences nea Prizren dhe
- Qendra e Kompetences ne Ferizaj

414

Numri i përgjithshëm i personelit në shkollat partnere të AAAPARr-së.

342

Numri i përgjithshëm i mesimdhënësve në shkollat partnere të AAAPARr-së.

4370

Numri i përgjithshëm i nxënësve në qendrat e kompetencës

6 QENDRA TE KOMPETENCES

17 DREJTIME:

Makineri,
Transport dhe Trafik,
Ndërtimtari,
Arte,
Elektroteknikë,
Tekstil,
Ekonomi,
Tregti dhe Hotelieri,
Turizëm,
Shëndetësi,
Energji, klimatizim dhe mjedis,
Ndërtimtari e lartë,
Ndërtimtari e ulët,
Arkitekturë,
Ekonomi,
Administratë.

54 profile:

Automekanik
Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi – IUK
Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit – INK
Metalpunues
Saldator
Mekatronikë
Dirigjimi kompjuterik i makinave
Transport Rrugor
Trafik Rrugor
Drejtues i trenave
Lëvizje e trenave
Konfeksioner
Rrobaqepës
Ndërtimtari
Arkitekturë
Gjeodezi
Dizajn i tekstit dhe veshjeve
Dizajn grafik
Dizajn Enterier
TIT (Telekom)
Dizajn Softverik
Informatikë
Instalues elektrik
Makina elektrike
Nëpunës i Industrisë
Nëpunës finance
Administrim zyre

Shërbime ndaj konsumatorit dhe shitjes
Nëpunës i eksport-importit
Asistent në menaxhimin e ngjarjeve
Udhëheqës i grupit turistik
Asistent në agjencinë turistike dhe zyrën e informacionit
Asistent i Kujdesit Social dhe Shëndetësor
Teknik Dentar
Teknik i Farmacisë
Teknik i Optikës
Asistent i Sigurisë Ushqimore dhe Dietat
Asistent i Fizioterapisë
Beton punues
Llamarinë punues dhe punues metal
Murorë dhe pllakashtrues
Ndërtues i konstruksioneve të thata
Ngjyrrë punues, llak punues
Ndërtues i rrugëve
Punëtor pejsazhi
Montues i gypave, ndërtimi i kanaleve
Dizajn i tekstit dhe veshjeve
Dizajn enterieri
Banka dhe Shërbime të Sigurimeve
Logjistikë dhe Operim ne Magazinë
Shitje dhe Marketing
Shërbime te zyrës dhe Administratës
Shërbime te TIK-ut
Hotelieri dhe Shërbime te Turizmit



Niveli i pestë arsimor, kualifikimi “ Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta”

Agjencia për Arsimit dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës Teknologjisë e Inovacionit dhe me mbështetjen e projektit Lux-Development, kanë zhvilluar kualifikimet e nivelit të pestë arsimor si: “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” dhe “Këshilltar për Karrierë”.

Kualifikimi “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”, ka filluar nga shtatori i vitit 2017/18 me 54 kandidatë në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, pastaj është vazhduar me gjenerata tjera, gjenerata e dytë në vitin 2018/19 me 75 kandidatë të regjistruar, gjenerata e tretë për vitin shkollor 2019/20, me 52 kandidatë të regjistruar, gjenerata e katërt 2021/22 me 50 kandidatë dhe tani aktualisht gjenerata e pestë 2022/23 me 184 kandidatë të regjistruar. Deri me tani këtë nivel të kualifikimeve e kanë përfunduar gjithsej 178 të diplomuar, prej tyre janë punësuar rreth 80%.

Kualifikimi është i përshtatur sipas Kornizës vetë-rregulluese të organizatë angleze PEARSON, Institucion ky shumë prestigjioz që ofron kualifikime në 70 vende të botës.





REALIZIMI
I PRAKTIKËS
PROFESIONALE



Orientimi në Karrierë

Duke e kuptuar rëndësinë e orientimit për karrierë për nxënësit e shkollave profesionale, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr), ka themeluar 6 Qendra për Karrierë, në 6 Qendrat e Kompetencës.

Këto Qendra janë themeluar si rezultat i një partneriteti dhe bashkë-investimit në mes të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur dhe projektit Rritja e Punësimit përtë Rinj (EYE) i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Qendrat për Karrierë do të ndihmojnë rreth 4370 nxënës të këtyre shkollave për të zhvilluar një karrierë të suksesshme arsimore, profesionale dhe jetësore, si dhe do të mundësojnë ndërlidhjen më të mirë të shkollës me tregun e punës. Nxënësit e tanishëm, nxënësit e ardhshëm, nxënësit e diplomuar, të rriturit që braktisin shkollën, bizneset, prindërit dhe komuniteti në përgjithësi do të përfitojnë nga këto qendra për karrierë.

Në kuadër të bashkëpunimit me projektin EYE, kemi vazhduar tutje në zhvillimin e kaulifikimit dhe ngritjen e kapaciteteve në fushën e Këshillimit në Karrierë.

Është zhvilluar programi kualifikues pëe këshillim në Karrierë i nivelit të pestë arsimore, i cili do të shërbej për të marë kualifikimin të gjithë atyre që dëshirojnë të punësohen në Qendrat e karrierës por edhe në institucionet tjera relevante, publike apo private.

Kualifikimi është validuar dhe bashkë me të e ka marrë Akreditimin edhe Qendra e Kompetencës në Prizren, si qendër ofruese e kualifikimi. Perpos kësaj, kemi ngrit edhe kapacitetet profesionale të stafit të Qendrave të Karrierës, duke ofruar trajnimin për trajner për keshilltarë e ardhëshëm të karrierës.



Ofrimi i mësimi Dual, si perspektive e të rinjëve

Si pjesë e politikës zhvillimore MASHTI ka bërë kërkesë për ofrimin e mesimit dual në AAP. Arsimit dual po pilotohet për herë të parë nga ky vit shkollor me 5 klasë të nxënësve të klasave të 10-ta, në profilet: Floktari, Kuzhinier, Asistent i mikpritjes hoteliere dhe Murator.

Qëllimi i arsimit dual është përgatitja e kuadrove me shkathtësi dhe kompetenca të duhura sipas nevojave të tregut të punës. AAAPARr, këtë formë të arsimit po e ofron përmes Qendrës së Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë, në profilin e Floktarisë.



Arsimi për të Rritur

Si rezultat i bashkëpunimit në mes të Agjencionit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur dhe organizatës DVV International në Kosovë u prezantua hulumtimi për ofrimin e kurseve afatshkurtëra modulare për Arsimin për të Rritur në IAAP.

Ofrimi i kurseve afatshkurtëra modulare është mundësi mjaftë e mirë e zbatimit të komponentës së ARr-së në kontekstin e mësimin gjatë gjithë jetës për individ të papunë, për rikualifikim, zhvillim në profesion, grupe të pa inkuadruara dhe shoqërinë në përgjithësi.

Përmes ofrimit të programeve të tilla si kërkesë e tregut të punës, përfitojnë individët, shkollat dhe sistemi arsimor në përgjithësi, duke ofruar programe cilësore dhe të avancuara në kontekstin e zhvillimit teknologjik, ekonomik e social.



